

4.5 DYSHEME SPORTIVE

FLOORCOAT FINAL



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
5 kg/kovë 15 kg/kovë	36 cp/paletë 36 cp/paletë	0.3-0.5 kg/m ²	E Bardhë E Kuqerremtë



FLOORCOAT FINAL

Bojë me bazë rezinash akrilike në dispersion ujqor, gjysmëfleksibël për lyerjen e fushave sportive

KARAKTERISTIKAT

Bojë gjysmëfleksibël për ambiente të brendshme dhe të jashtme me bazë rezinash akrilike në dispersion ujqor dhe fillerash me granulometri të seleksionuar. Për shkak të formulacionit të produktit FLOORCOAT FINAL ka mbulueshmëri shumë të mirë dhe jetëgjatësi. Produkti ka rezistencë të lartë ndaj kushteve të ndryshme të motit dhe ndaj abrazionit. Produkti ka veti shumë të mira ngjitëse si në sipërfaqe të reja ashtu edhe në ato të paralyera.

FUSHAT E PËRDORIMIT

FLOORCOAT FINAL përdoret për lyerjen e fushave sportive si për shembull, fusha tenisi, fusha basketbolli, fusha handbolli, fusha volejbolli, pistën e tartarit në fusha futbollit, etj. Aplikohet mbi sipërfaqe betoni, asfalti, etj.

MËNYRA E PËRDORIMIT

1.Përgatitja e sipërfaqes

Suporti ku do të aplikohet FLOORCOAT FINAL paraprakisht duhet të pastrohet nga pluhurat si edhe mbetjet e naftës, vajrave verniqeve, dyllit dhe nga materialet kundër ngjitjes. Pastrimi i vajrave, verniqeve, dyllit apo materialve kundër ngjitjes realizohet mekanikisht ose në mënyrë manuale. Më pas bëhet astarosja e sipërfaqes duke përdorur produktin FLOORCOAT PRIMARY.

2.Përgatitja e produktit

FLOORCOAT FINAL mund të hollohet me 10% - 15% ujë dhe përzieret me anën e një mikseri të përshtatshëm për homogjenizim. Më pas bëhet aplikimi i produktit duke përdorur një furçe, rrul ose me spërkatje. Aplikimi i produktit bëhet me dy shtresa dhe shtresa e dytë aplikohet 12 - 24 orë mbas aplikimit të shtresës së parë.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Baza kimike	Dispersion Akrilik
Pesha specifike e masës	1,50±0,05 Kg/lit
Temperatura e zbatimit	Nga +10°C deri +35°C
Koha e rilyerjes	12 - 24 orë
Shkelja	Rreth 24 orë në bazë të temperaturës

PAKETIMI

Ne kova 5 Kg dhe 15 Kg

KONSUMI

Sipërfaqe e lëmuar: 250 - 300 gr/m² / shtresë

JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

Ruhet në një ambalazh të mbyllur mirë në mjedise të thata dhe me hije e me lagështi të ulët, të paktën për 12 muaj nga data e prodhimit.

